



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 2716/1 Prot.,

Tiranë, më 16.07.2024

VENDIM

Nr. 18, datë 16.07.2024

“PËR

“CAKTIMIN E PIKËS SË KONTAKTIT ME KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
PËR MONITORIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT TË KOMUNIKIMIT”

Këshilli i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në mbledhjen e tij të datës 16.07.2024, bazuar në nenet 26, 27, 28, 38 të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”, Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, në nenet 9, 10, 16 të vendimit Nr. 71, datë 20.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës”, vendimin Nr. 454, datë 02.11.2022 “Për miratimin e planit të komunikimit për gjykatat” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendimin Nr. 16, datë 22.11, 2022 të Këshillit të Gjykatës; vendimin Nr. 15, datë 15.07.2024 “Për transferimin e përhershëm të znj. Dinora Aleks, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit civil gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist i protokollit”, në Sektorin e Protokoll – Arkivës, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të Këshillit të Gjykatës dhe vendimin Nr. 16, datë 15.07.2024 “Për transferimin e përkohshëm të zj. Elsa Lita, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit civil gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist i Marrëdhënieve me publikun, median dhe me jashtë, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të Këshillit të Gjykatës,

V E N D O S I:

1. Të caktojë pikën e kontaktit me Këshillin e Lartë Gjyqësor për monitorimin dhe zbatimin e planit të komunikimit, nëpunësin për marrëdhëniet me median dhe publikun, Zj. Elsa LITA, e cila ka për detyrë që çdo tre muaj të raportojë pranë “Drejtorisë për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun në Këshillin e Lartë

Gjyqësor” zbatimin e planit të komunikimit sipas formatit të raportimit që është shtojcë e planit të komunikimi.

2. Ky vendim t’i njoftohet Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëpunëses për marrëdhëniet me median dhe publikun, Zj.Elsa LITA dhe Kancelarit.
3. Ngarkohet Kancelari që me mbështetjen e IT-së të publikojë këtë vendim në faqen e web-it të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Këshillit të Lartë Gjyqësor.
4. Shfuqizimin e vendimit Nr. 16, datë 22.11, 2022 të Këshillit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KËSHILLI I GJYKATËS

Anëtar/Kancelar

Saimir SHYTI

Kryetar/Zëvendëskryetar

Erjon BANI



Anëtar/Gjyqtar

Erjon CELA